

VENDIM
Nr. 86, datë 3.2.2016

**PËR TRANSFERIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË SË SHOQËRISË “QENDRA
SPORTIVE” SHA, TIRANË, ME KAPITAL 100 PËR QIND SHTETËROR, NGA
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES, TE BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shoqëria “Qendra sportive” sh.a., Tiranë, me kapital 100 për qind shtetëror, aktualisht në pronësi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, transferohet në pronësi të Bashkisë Tiranë, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama